

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
NJOFTIM KONTRATE TE PROCEDURES KONCESIONARE
ME

NR. REFERENCE REF-23464-08-08-2017

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktues

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues Emri Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Adresa Sheshi "Skënderbej", Nr. 5, Tiranë Tel/Fax +355 4 2 380 750 E-mail
info@transporti.gov.al Faqja e Internetit www.transporti.gov.al

1.2 Emri dhe adresa e personit të kontaktit Emri Z. Muharem Çakaj Drejtor i Drejtorisë së
Shërbimeve Juridike Adresa: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së
Shqipërisë Sheshi "Skënderbej", Nr. 5 Tirana, Albania Email: Muharem.Cakaj@transporti.gov.al
Çdo komunikim, pyetje, sqarim ose informacion që kërkohet nga Ofertuesit e Mundshëm rreth
Procedurës së Tenderit duhet t'i adresohet vetëm Personit të Kontaktit të sipërcituar.

1.3 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore: Institucion qëndror
Institucion i pavarur P Njesi e Qeverisjes Vendore
Seksioni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Lloji i Kontratës Kontratë e punëve publike

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

2.2.1 Forma e Kontratës: Koncesion/PPP

2.2.2 Objekti i Kontrates: Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbërit.

2.3 Kohëzgjatja e Kontrates ose afati kohor për ekzekutimin: Kohëzgjatja: 13 vjet

2.4 Vendndodhja e Objektit të Kontratës Rruga e Arbrit fillon ne verilindje te qytetit të Tiranës
dhe përfundon në Pikën kufitare të Bllatës, Dibër.

2.5 Ndarja në LOTE: P Jo *Po Nëse po:

2.6 Përshkrimi i shkurter i loteve:

1 _____

2 _____

3 _____

2.7 Opsionet: Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka): Ose: nga ___ në ___

2.8 Do të pranohen variantet P Jo *Po

2.9 Do të pranohet nënkontraktimi: Po X Jo Nëse do të lejohet nënkontraktimi, të specifikohet
përqindja e lejuar për nënkontraktimin: E papërcaktuar. Autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të
drejtpërdrejtë nënkontraktorit: PPo Jo

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510

<https://www.app.gov.al> 332/366

2.10 Kontratë në kuadër të një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një shtet Tjetër.
P Jo *Po

2.11 Vlera e Parashikuar e Projektit Vlera e parashikuar e projektit është vlera totale e pagesave
maksimale të disponueshmërisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Vlera e parashikuar e
projektit në bazë të studimit është: 33,600,000,000 lekë (pa t.v.sh).

2.12 Monedha: Monedha e ofertës do të jetë në Lekë.

Seksioni 3 Informacion ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimi Sipas Shtojcës 9 kriteret e Kualifikimit

3.2 Sigurimi i Ofertës (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor) Operatori ekonomik që të marrë pjesë në një procedurë konkurrimi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjendet në Shtojcën 6. Vlera e sigurimit të ofertës është 2% e vlerës së projektit të propozuara nga ofertuesi.

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i Procedurës: E hapur P E kufizuar*

4.2 Kriteret e Përzgjedhjes së fituesit:

1 Propozimi teknik për ndërtimin e rrugës dhe mirëmbajtjes.

a Projekt ide konceptual

b Metodologjia e punimeve

c Plani/ operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë (tabela)

d Sinjalistika e përkohshme dhe Siguria në kantier gjatë ekzekutimit të punimeve të ndërtimit.

2 Ndikimi mjedisor

3 Ndikimi social

4 Afati i përfundimit të punimeve

5 Oferta Financiare

4.3 Afati i Dorëzimit të Ofertave është: Data: 02 Tetor, 2017 Ora: 12.00 MD Ora e Evropës Qendrore Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë Dokumentet e Ofertës së tyre në anglisht ose shqip, në format elektronik, duke i ngarkuar ato përpara Afatit të Dorëzimit në portalin në internet të Agjencisë së Prokurimeve Publike të Shqipërisë në www.app.gov.al. Ofertat e dorëzuara pas Afatit të Dorëzimit do të refuzohen. Udhëzimet për ngarkimin e Dokumenteve të Ofertës mund të gjenden në gjuhët shqipe dhe angleze në portalin në internet të Agjencisë së Prokurimeve Publike të Shqipërisë në www.app.gov.al. Kërkesat për qartësim në lidhje me dorëzimin elektronik të Dokumenteve të Ofertës do t'i dorëzohen Personit të Kontaktit në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 1.2 të këtij Njoftimi. Secila faqe e dokumenteve që përmbahen në Ofertën origjinale duhet të jenë të numëruara sipas radhës dhe të sigluara. Të gjitha shifrat e shprehura në Ofertë duhet të jenë të shprehura në formatin e mëposhtëm “1,000 (një mijë)” dhe në rast të mospërputhjes fjalët do të kenë përparësinë ndaj numrave.

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave: Data: 02 Tetor, 2017 Ora: 12.00 MD Ora e Evropës

Qendrore 4.5 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave: Çdo Ofertë do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 8 (tetë) muaj pas afatit të Dorëzimit. Oferta nga Ofertuesi i Përzgjedhur do të jetë e vlefshme deri në Datën Efektive dhe Autoriteti Kontraktues do të jetë në gjendje të kërkojë që Oferta e një Ofertuesi

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510

<https://www.app.gov.al> 333/366

të Mundshëm të pasuksesshëm të zgjatet për çdo kohëzgjatje deri në Datën Efektive, ku kjo zgjatje të jetë në diskrecionin e Ofertuesit të Mundshëm.

4.6 Gjuha e ofertës: * Anglisht P Shqip Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione Plotësuese

5.1 Qendra Virtuale e të Dhënave Një Ofertues i Mundshëm do të gjejë të gjithë informacionin lidhur me Kontratën: Projekt Idenë, specifikimet minimale teknike, kriteret e kualifikimit në faqen elektronike të prokurimeve www.app.gov.al

5.2 Pyetjet Kërkesat për sqarim rreth Dokumenteve të Procedurës Konkurruese duhet të dorëzohen brenda afatit ligjor përmes e-mail tek personi i kontaktit i përcaktuar në paragrafin 1.2

Kërkesat për sqarim mund të dorëzohen çdo moment përpara: Datës 27 Shtator 2017 Ora: 12:00 MD Ora e Evropës Qendrore Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë i detyruar t'i përgjigjet asnjë kërkesë për sqarim apo ndonjë komunikimi tjetër pas kësaj date. Autoriteti Kontraktues do të shpërndajë përgjigjet ndaj kërkesave për sqarim përmes faqes elektronike www.app.gov.al

5.3 Të Dhënat dhe Informacioni mbi Projektin

Autoriteti Kontraktues ka përfunduar analizat e mëposhtme, raportet e të cilave janë vënë në dispozicion për Ofertuesit e Mundshëm në Faqen Virtuale të të Dhënave: Rruga e Arbrit është: (i) përfunduar plotësisht në 20.12 km, (ii) përfunduar pjesërisht në 15.175 km, si dhe (iii) ka një projekt ekzistues edhe për 26.372 km. Në total janë 61.667 km të projektuar për gjurmën kryesore me standardin C3, nga të cilët 26.372 km nuk janë prekur me punime ndërtimi. Sipas Studimit të fizibilitetit të hartuar rreth vitit 2005 e gjithë gjurma Tiranë-Bllatë sipas këtij varianti pritet të jetë afërsisht rreth 73.5 km e gjatë, çka do të thotë që afërsisht në total 11.8 km rrugë janë ende të pa projektuar (gjatësi në skajin e lidhjen me Tiranën dhe gjatësi në skajin e lidhjes me Blladën - pika kufitare).

Në këto kushte Projekt Ideja për “Përmirësim, Ndërtim, Operim, dhe Mirëmbajtje e Rrugës së Arbrit” për kompletimin e të gjithë gjurmës së Rrugës së Arbrit që përfshin: projektet e segmenteve të pa projektuar (skajet lidhëse), përmirësimin e projekteve të segmenteve ku punimet janë ende të papërfunduar me synimin e përmirësimit të tyre nga standardi C3 te standardit të vitit 2001 në atë C2 sipas standardit të vitit 2015, përmirësimin e projekteve të zbatimit për segmentet ku ka projekt zbatim por që nuk është ndërtuar duke përmirësuar standardin C3 të rrugës sipas standardit të vitit 2001 në atë C2 sipas standardit të vitit 2015 dhe mirëmbajtjen e segmenteve të ndërtuara. Në projekt ide, të nxitur nga rëndësia që ka segmenti Zall Bastar-Dalja e Urës së Vashës, që është sa 1/3 e të tërë Rrugës së Arbrit është studiuar dhe projektuar sipas standardit C2 të vitit 2015 ku është projektuar edhe lidhja e Rrugës së Arbrit me Klosin.

Në projekt ide është marrë në konsideratë distanca kohore më e shkurtër, siguria e kërkuar në tunele, pasi parashikon edhe një tub emergjence, krahas atij kryesor dhe aksesit me i shpejt i rrugës nga banoret e Matit përmes lidhjes me Klosin. Kështu, në Projekt Ide, Rruga e Arbrit nga Tirana deri në Bllatë skematikisht në mënyrë të njëpasnjëshme është e ndarë në 8 segmente si më poshtë: Segmenti 1, fillon në dalje të Tiranës, aty ku mbaron rruga ekzistuese, dhe përfundon tek Ura e Brarit, aty ku kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës. Gjatësia e tij është 1.153 km. Segmenti 2 : Ura e Brarit - Zall Bastar, me L=5.46 km. Segmenti 3: Zall Bastar – Dalja e Urës së Vashës, sipas projekt idesë është me gjatësi L=23.188 km. Segmenti 4: Dalja e Urës së Vashës – Bulqizë, me gjatësi L=9.715 km. Segmenti 5: Bulqizë-Ura e Çerenecit, me L=20.12 km, i përfunduar në v. 2009 dhe 2011. Nuk është pjesë e Projekt Idesë. Segmenti 6: sipas studim-projektim që lidh Urën e Çerenecit me rrugën Maqellarë-Pika kufitare Bllatë. Gjatësia e tij është L=9.111 km. Segmenti D (7): Për të plotësuar nevojat e trafikut të ardhshëm, rruga ekzistuese Maqellarë-Pika kufitare Bllatë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510

<https://www.app.gov.al> 334/366

duhet të rikonstruohet në standardin e një rruge urbane për shpërndarjen e të tërë trafikut të Rrugës së Arbrit në Drejtim të Peshkopisë (Maqellarë) dhe Maqedonisë (Pika kufitare Bllatë). Segmenti K (8) është degëzimi Dalje Ura e Vashës - Klos (Segmenti K) me L= 3.092 km.

Projektet e segmenteve 1 deri 6 (përveç segmentit 5-që nuk është pjesë e Projekt Idesë) janë hartuar sipas Standardin C2 të Manualit për Projektimin e Rrugëve Shqiptare – MPRrSh 2 – Projektimi Gjeometrik (viti 2015). Ky standard kënaq kërkesat që burojnë nga Studimi i

Fizibilitetit për Rrugën e Arbëri. Ky standard, kërkesat evropiane të sigurisë për rrugët automobilistike dhe elementëve përbërës të tyre. Segmenti D është projektuar për të plotësuar nevojat e kalimtarëve, trafikut urban dhe ato në interes të Rrugës së Arbrit. I vetmi Segment i projektuar në standardin C3 është ai i degëzimit për në Klos (Seg. K), kjo në përputhje me volumit e trafikut në atë rrugë. Proceset dhe Rregullat e Qendrave të të Dhënave Ofertuesit e Mundshëm do të gjejnë gjithë informacionin e kërkuar në faqen elektronike të prokurimeve ëëë.app.gov.al 5.4 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) Përveç rasteve të deklaruara ndryshe, të gjitha referencat e kostove, shpenzimeve, tarifave dhe çmimeve do të shprehen pa TVSH. 5.5 Kufizime E drejta për të pezulluar procedurën konkurruese: Autoriteti kontraktues rezervon te drejtën për te pezulluar procedurën konkurruese ne mënyrë të përkohshme ose te përhershme në bazë të diskrecionit të tij. Ofertuesit e mundshëm nuk kane të drejtë të kërkojnë kompensim, kosto ose shpenzime në rast se procedura konkurruese pezullohet. Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 10.08.2017